

20121062747

L I G J **PËR EMETIMIN E BONAVE ME VLERE -VAUÇEREVE**

Neni 1

Me kete ligj rregullohet emetimi i bonave me vlere - vauçereve, për blerjen e kompjutereve për nevojat e studenteve të rregullt shtetas të Republikës së Maqedonise, që jetojne në familjet e rrezikuara sociale dhe të cilet për here të pare jane regjistruar në vitin perfundimtar të studimeve në vitin shkollor 2012/2013, në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise dhe për studentet që jane të evidentuar si persona me nevoja të vecanta, të regjistruar në studime në vitin shkollor 2012/2013 në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise.

Neni 2

Studente të rregullt të cilet për here të pare jane regjistruar në vitin perfundimtar të studimeve në vitin shkollor 2012/2013 në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise sipas ketij ligji, jane të gjithë studentet e rregullt shtetas të Republikës së Maqedonise që jetojne në familjet e rrezikuara sociale dhe jane të regjistruar për here të pare në vitin perfundimtar në institucionet e arsimit të larte deri më 15 tetor 2012.

Studente që jane të evidentuar si persona me nevoja të vecanta, jane të gjithë studentet e regjistruar në vitin shkollor 2012/2013 në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise, e që jane të evidentuar si persona me nevoja të vecanta.

Si familje të rrezikuara sociale nga paragrafi (1) i ketij neni nenkuptohen familjet shfrytezuese të ndihmes sociale në para, ndihmes së perhershme në para dhe të drejtes për ndihme në para të personit i cili deri në moshen 18 vjecare ka pasur status të femijes pa prinder dhe kujdes prinderor ose familjet në të cilat të hyrat e pergjithshme mujore nuk jane më të medha se 12 000 denare.

Neni 3

Studenti i rregullt deshmon se eshte nga familje e rrezikuar sociale me vertetim të leshuar nga qendra për pune sociale apo certificate të leshuar nga Drejtoria e të Hyrave Publike, për të hyra të realizuara në baza të ndryshme nga viti paraprak (të hyra nga veprimtaria e pavarur, të hyra nga kryerja e veprimtarise bujqesore, të hyra nga prona dhe të drejta pronesore, të hyra nga kapitali, fitime të kapitalit, fitime nga lojerat e fatit dhe lojerat tjera shperblyese, rroga e realizuar të anetareve të punesuar të familjes ose e studentit të rregullt dhe të hyra tjera), për të dy prinderit apo kujdestaret e studentit veç e veç dhe për vet studentin. Vertetimi apo certificate dorezohen në sherbimin e studenteve të fakultetit amë.

Sherbimi i studenteve i fakultetit amë, vertetimet apo certificate bashke me listen e perpiluar për numrin e studenteve të rregullt të regjistruar që jane nga familjet e rrezikuara sociale të regjistruar për here të pare në vitin perfundimtar të studimeve në vitin shkollor 2012/2013 në institucionet e arsimit të larte, i dorezon në Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

Pas grumbullimit dhe kontrollimit të dokumenteve nga paragrafi (2) i ketij neni, Ministria e Arsimit dhe Shkences, të njejtat i dorezon në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates më së voni deri më 25 tetor 2012.

Neni 4

Bonat me vlere – vauçeret emetohen në vlere nominale prej 15 500 denaresh.

Neni 5

Mjetet për emetimin e bonave me vlere – vauçereve jane siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonise për vitin 2012.

Neni 6

Bonat me vlere – vauçeret emetohen në forme të materializuar dhe jane në emer të pruresit.

Neni 7

Dizajnin dhe shtypjen e bonave me vlere – vauçereve në pajtim me Ligjin për furnizime publike, i kryen Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates mban evidence për vauçeret e emetuar, kryen dorezim të vauçereve te institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise dhe e zbaton proceduren për bonat me vlere - vauçeret e emetuar.

Neni 8

Për evidence dhe identifikim të shfrytëzuesit të bonit me vlere – vauçerit, Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates siguron ueb aplikacion në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Neni 9

Bonat me vlere – vauçeret jane me perdorim të njehershem dhe perdoren si pjesemarrje për blerje të kompjutereve: laptop, desktop ose tablet.

Bonat me vlere – vauçeret perdoren për blerjen e kompjutereve nga paragrafi (1) i ketij neni nga subjekte (shoqeri tregtare dhe tregtare individe) që jane të regjistruar për veprimtari të lidhura me tregti, mirembajtje dhe riparim të kompjutereve.

Subjektet nga paragrafi (2) i ketij neni duhet të ekzistojne në treg më gjate se një vit, t'i kene vendet e tyre të shitjes dhe të kene më shume se dy persona të punesuar.

Gjate realizimit të vauçereve subjektet nga paragrafi (2) i ketij neni, duhet të leshojne fletegaranci me numer serik të pajisjes.

Neni 10

Pagesa për bonat e emetuara me vlere – vauçeret kryhet nga Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Pagesa e mjeteve për subjektet nga neni 9 paragrafi (2) i ketij ligji, behet në baze të bonave me vlere – vauçereve të shfrytëzuar të dorezuar, kopjes së llogarise fiskale dhe kopjes së marreveshjes për shitblerje të kompjuterit.

Neni 11

Gjate pranimit të vauçereve, subjektet nga neni 9 i ketij ligji, detyrohen që për identifikim të shfrytëzuesit të vauçerit ta shfrytëzojne ueb aplikacionin nga neni 8 i ketij ligji, për cfare Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates detyrohet t'u siguroje qasje.

Subjektet detyrohen që për çdo vauçer të pranuar të mbajne evidence në të cilen shenohet emri dhe mbiemri i studentit, numri i indeksit, numri i leternjoftimit ose dokumentit të udhetimit, numri serik i bonit me vlere-vauçerit dhe të kete nenshkrim personal të studentit në baze të formularit të plotësuar dhe deklarate për blerje të kompjuterit me vauçer, me të cilin deklaron se e ka dorezuar bonin me vlere-vauçerin me numrin e shenuar serik.

Modelin e formularit me deklaraten nga paragrafi (2) i ketij neni, e percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Neni 12

Bonat me vlere – vauçeret mund të shfrytëzohen për blerjen e kompjutereve më së voni deri më 15 dhjetor 2012.

Subjektet nga neni 9 i ketij ligji, mund t'i dorezojne vauçeret për arketim në Ministrinë e Shoqerise Informatike dhe Administrates, më së voni deri më 22 dhjetor 2012 dhe të kryejne arketim të vauçereve më së voni deri më 26 dhjetor 2012.

Neni 13

Shperndarjen e bonave me vlere – vauçereve neper institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise e kryen Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates në baze të listes së perpiluar nga Ministria e Arsimit dhe Shkences për numrin e studenteve të rregullt të regjistruar, që jane nga familjet e rrezikuara sociale, të regjistruar për here të pare në vitin perfundimtar të studimeve 2012/2013 dhe të studenteve të evidentuar si persona me nevoja të vecanta të regjistruar në vitin shkollor 2012/2013 në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise.

Në rast se shuma e shperndare e numrit të vauçereve në institucionet e arsimit të larte në Republikën e Maqedonise nuk shfrytezohet plotesisht, institucioni i arsimit të larte detyrohet që me procesverbal bonat me vlere – vauçeret t'i ktheje në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates detyrohet ta njoftoje Qeverine e Republikës së Maqedonise në afat prej tri ditesh nga shperndarja e kryer e bonave me vlere – vauçereve për numrin që eshte shperndare neper institucione të vecanta të arsimit të larte në Republikën e Maqedonise.

Neni 14

Studenti gjate marrjes së bonit me vlere – vauçerit në institucionin e arsimit të larte, detyrohet që të plotesoje formular me deklarate për pranim të bonit me vlere – vauçerit për blerje të kompjuterit në të cilin e shenon emrin dhe mbiemrin e tij, numrin e leternjoftimit ose dokumentit të udhetimit, numrin e indeksit dhe numrin serik të bonit me vlere-vauçerit që e ka marre.

Personi pergjegjes për distribuim të bonave me vlere-vauçereve në institucionin e arsimit të larte, detyrohet që numrin e leternjoftimit, perkatesisht të dokumentit të udhetimit të studentit ta regjistroje në bonin me vlere-vauçerin në vend të caktuar për kete, para se t'ia dorezoje të njejtin studentit.

Personi pergjegjes për distribuim të bonave me vlere-vauçereve në institucionin e arsimit të larte, para se ta jape bonin me vlere – vauçerin, detyrohet që t'i fuse të dhenat nga paragrafi (2) i ketij neni në ueb aplikacionin nga neni 8 i ketij ligji.

Modelin e formularit me deklaraten nga paragrafi (1) i ketij neni, e percakton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates.

Neni 15

Institucionet e arsimit të larte detyrohen që në afat prej 15 ditesh nga dita e pranimit të bonave me vlere – vauçereve, të dorezojne raport për numrin e bonave me vlere – vauçereve të shperndare studenteve në pajtim me kete ligj, në Ministrine e Shoqerise Informatike dhe Administrates dhe në Ministrine e Arsimit dhe Shkences.

Neni 16

Gjate pranim-dorezimit të vauçereve ndermjet Ministrise së Shoqerise Informatike dhe Administrates dhe institucioneve të arsimit të larte, detyrimisht mbahet procesverbal për pranim-dorezimin, i cili doemos duhet të nenshkruhet prej së paku tre personave pergjegjes nga subjektet ndermjet të cileve behet pranim-dorezim i bonave me vlere-vauçereve.

Neni 17

Bonat me vlere-vauçeret e pashfrytezuar të emetuar në pajtim me kete ligj, Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates dhe Ministria e Puneve të Brendshme i anulojne me komision më së voni deri më 10 janar 2013.

Neni 18

Ministri Shoqerise Informatike dhe Administrates miraton Udhezim për zbatimin e ketij ligji.

Neni 19

Mbikeqyrje mbi zbatimin e dispozitave të ketij ligji dhe shfrytëzimin me dedikim të bonave me vlere – vauçereve, kryejne Ministria e Arsimit dhe Shkences - Inspektorati Shteteror i Arsimit dhe Ministria e Ekonomise - Inspektorati Shteteror i Tregut.

Neni 20

Ngarkohet Ministria e Shoqerise Informatike dhe Administrates që të dorezoje raport të plote për realizimin e ketij ligji nepermjet Qeverise së Republikes së Maqedonise në Kuvendin e Republikes së Maqedonise, perfundimisht deri më 31 janar 2013.

Neni 21

Secili që do ta keqperdor bonin me vlere - vauçerin e emetuar në pajtim me kete ligj ose do ta falsifikoje, do të pergjigjet për veper të kryer penale në pajtim me Kodin penal.

Neni 22

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në “Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise”, ndersa do të zbatohet deri më 1 shkurt 2013.